

Бр. / Nr. 10-8408 / 1
24-12-2024 20 год. / viti

Në bazë të nenit 16 të Ligjit për lojërat e fatit dhe për lojërat argëtuese ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 24/11, 51/11, U.nr. 53/11 132/11, 148/11, 74/12, 171/12, 27/14, 139/14, U.nr.8/14, 61/15, 154/15, 23/16, 178/16 dhe U.nr. 65/17), neni 29 i Ligjit për organizatat e invalidëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 89/2008; 59/2012 dhe 23/2013), neni 89 i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje (24/21) dhe neni 73 dhe neni 83 i Ligjit për mbrojtje sociale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 104/19, 146/19, 275/19, 302/20, 311/20, 163/21, 294/21, 99/22, 236/22 dhe 65/23) Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë publikon

THIRRJE PUBLIKE

për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatave dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut

I. Qëllimet e thirrjes publike:

1. Sigurimi i mbështetjes financiare të projekteve/programmeve prioritare, aktiviteteve të Organizatave Nacionale të Invalidëve në drejtim të avancimit të gjendjes së personave në nevojë;
2. Ofrimi i mbështetjes financiare për ofrimin e shërbimeve të specializuara për dhunën në familje si shërbime informacioni dhe udhëzimi, shërbime këshillimi dhe shërbime të qëndrimit të përkohshëm për gratë viktime të dhunës në familje dhe fëmijët e tyre;
3. Sigurimi i mbështetjes financiare i aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes sociale të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut

II. Mënyra e përzgjedhjes dhe kriteret më të afërta për renditjen e programeve të paraqitura

Në bazë të propozim programeve të parashtruara, në pajtim me kriteret më të afërta në thirrjen publike, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të kryejë zgjedhje të aktiviteteve projektuese/programore të cilat do të mbështeten financiarisht me mjetet e siguruara në përputhje me Ligjin për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese, kurse propozim projektet/programet e pranuar do të përfshihen në Programin për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të ardhurat e lojërave të fatit dhe nga lojërat argëtuese për vitin 2025.

Kriteret për zgjedhje të programeve dhe projekteve të cilat do të financohen në pajtim me Ligjin e lojërave të fatit dhe lojërave argëtuese për vitin 2025 definojnë në:

1. Procedurën interne për sigurimin e mbështetjes financiare të projekteve/programeve prioritare të Organizatave Nacionale të Invalidëve në pajtim me Thirrjen publike për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
2. Procedurën interne për përcaktimin e kriterëve dhe metodologjisë për renditjen dhe zgjedhjen e projekteve të shoqatave për luftë kundër dhunës në familje në pajtim me Thirrjen publike për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
3. Procedurën interne për sigurimin e mbështetjes financiare të aktiviteteve nga fusha e mbrojtjes sociale të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me Thirrjen publike për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
4. Procedura interne për përcaktimin e kriterëve dhe metodologjisë për rangimin dhe përzgjedhjen e projekteve për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara përmes projekteve të inovacionit digjital në përpunime me Thirrjen Publike për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale invalidore, shoqatave të tyre dhe asociacioneve të tyre, të shoqatave për të luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

III. Dokumentacioni i nevojshëm

- Fletëparaqitje - aplikacion me shënim për cilin qëllim specifik nga thirrja aplikon (1, 2, 3 dhe 4).
- Propozim programi ose projekti me përshkrim të hollësishëm të qëllimeve, plan konkret i punës për implementim dhe periudha e realizimit të aktiviteteve me të cilat do të sigurohet realizimi i qëllimeve të parashikuara të projektit.
- Konstruksioni i hollësishëm financiar i nevojshëm për realizimin e aktiviteteve të parashikuara të programit/projektit në të cilën do të përfshihet edhe përlllogaritja e shpenzimeve për paga të personave të cilët do të marrin pjesë në realizimin.
- Titulli i plotë dhe adresa e subjekteve të tjera me aktivitete qartë të definuara gjatë realizimit të programit ose projektit.

- Numri i përgjithshëm dhe përvoja strukturore/profesionale e personave të paraparë për realizimin e programit ose projektit.
- Emri dhe mbiemri dhe të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për realizimin e programit ose projektit.
- Informacione për përvojën e mëparshme të organizatës në realizimin e projekteve të ngjashme.

IV. Shuma e mjeteve të cilat ndahen edhe periudha kohore në të cilën do të realizohen aktivitetet e punës

Shuma e plotë e mjeteve për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, do të sigurohet në pajtim me Ligjin për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese dhe Vendimin për përcaktimin e të ardhurave nga lojërat e fatit dhe nga lojërat argëtuese në vitin 2025 për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpërndarja e shumës së plotë të mjeteve të siguruara financiare në pajtime me Ligjin për lojërat e fatit dhe lojërat argëtuese të synuara për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2025, do të definohen në Programin për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga të ardhurat e lojërave të fatit dhe nga lojërat argëtuese në vitin 2025, në bazë të aktiviteteve programore projektuese të cilat do të pranohen nga ana e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

Kohëzgjatja e realizimit të aktiviteteve të mbështetura programore/projektuese do të jetë në pajtim me propozim projektet/programet e dorëzuara gjatë vitit 2025.

V. Afatet për zbatimin e procedurës

- Thirrja publike zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit në gazetën ditore dhe në ueb faqen e Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë.

- Afati përfundimtar për dorëzimin e aplikacioneve është deri në orën 16:30 në ditën e fundit të afatit të thirrjes publike.

- Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në afat prej 15 ditësh pas përfundimit të afatit për parashtrimin e fletëparaqitjeve, realizon procedurë për shqyrtim dhe zgjedhje të propozim programeve aktiviteteve projektuese, në bazë të së cilës do ta përgatisë Programin për financim të aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2025.

- Marrëveshjen për të drejtat e ndërsjella, obligimet dhe përgjegjësitë në realizimin e mbështetjes financiare të organizatës nacionale të invalidëve, dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë do të lidhë në afat prej 15 ditëve nga dita e publikimit të Vendimit për përcaktimin e të ardhurave nga lojërat e fatit dhe nga lojërat argëtuese në vitin 2025 për financimin e aktiviteteve programore të organizatave nacionale të invalidëve, dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Fletëparaqitja me dokumentet e parashtruara duhet të dorëzohen në arkiv ose përmes postës në Ministrinë e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë në adresën rr. Dame Gruev nr. 14 – Shkup, me shënim për Thirrje publike për financimin e aktiviteteve të programit të organizatave nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatave për luftë kundër dhunës në familje dhe për Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vërejtje: Fletëparaqitjet të cilat do të arrijnë pas afatit të paraparë për dorëzim nuk do të shqyrtohen.

Organizatata nacionale të invalidëve, shoqatat e tyre dhe asociacioneve të tyre, shoqatat për luftë kundër dhunës në familje dhe Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat do të mbështeten nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë kanë obligim që në të gjitha materialet (të shtypura dhe elektronike) të cilat do të prodhohen në kuadër të kësaj thirrje publike, në vend të dukshëm të qëndrojnë:

Mbështetur nga:

Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë



Република Северна Македонија

Министерство за труд
и социјална политика